CIVICA MOBILITAS

QYTETARËT PËR NDRYSHIM

KORRIK - SHTATOR 2019 // CIVICAMOBILITAS.MK

BULETIN NR.2

NIRAS FCG MACEDONIAN CENTER FOR INTERNATIONAL COOPERATION MCIC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Civica Mobilitas është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i cili zbatohet nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) dhe FCG Zhvillim Suedez AB (FCG Suedi)

AKTIVIZMI QYTETAR SJELL FRYTE

"Këmbëngulja paguhet edhe krahas të gjitha mohimeve, kërcënimeve, sulmeve fizike dhe verbale, torturave inspektuese nga pushteti, që nuk dëshironte të flasë e as të zgjidhë probleme me ujin e pasigurt në Gjevgjeli" – kjo është pjesë e postimeve në fejsbuk të iniciativës qytetare "Arsena" nga Gjevgjelia. Ata që në fillim, postimin e fillojnë me fjalët: Gjashtë vjet aktivizëm i palodhshëm qytetar që solli fryte dhe me këtë e caktuan fundin e një betejë të madhe për qytetarët, betejë në të cilën qytetarët e Gjevgjelisë fituan ujë të pastër dhe të pijshëm, ku siç thotë kryetari Pockov "nuk ka arsen, vetëm H20 rrjedh nëpër çezmat shtëpiake".

Civika mobilitas i mbështet aktivistët e palodhshëm të Arsena, të cilët bile 10 herë nënë analiza të ujit në laboratorin e licencuar ndërkombëtar që ta bindin pushtetin lokal të ndërmarrë hapa për zgjidhjen e problemit. Rezultatet shkuan edhe deri në 177% më shumë arsen nga kufiri maksimal i lejuar, sipas Organizatës Shëndetësore Botërore. Krahas pushtetit, aktivistët e "Arsena" i informuan edhe qytetarët, i edukuan, e pastaj bashkë me ata organizuan iniciativa të ndryshme që të bëhet presion për ndërtimin e sistemit të ri të puseve për furnizim me ujë. Dhe ia arritën!

Ky është shembull i mirë i aktivizmit ose angazhimit qytetar. Dhe për fat të mirë, nuk është i vetmi. Për shembull "Na tocak". Kur për herë të parë u tubuan, në verën e vitit 2012 shumë pak flitej, ndërsa akoma më pak bëhej për ndërgjegjësimin për biçikletën si mjet transporti. Ngritja në nivel të pjesëmarrësit të barabartë në komunikacion në Shkup, për çka edhe ata do të pajtoheshin, ishte vetëm një ide e mirë. Sot, pas shtatë viteve aktivizëm dhe #81 Masa kritike të vozitura vetëm në Shkup, mijëra njerëz kishin vetëdije personale për çiklizmin urban. Dhe atë jo vetëm në Shkup, por edhe në qytetet tjera në vend. Shkupi ka mbi 80 km shtigje për çiklizëm, nëpër qytet dhe në bregun e lumit, ndërsa pushtet lokale punojnë në rikonstruimin dhe ndërtimin e të rejave, me të cilat do të lidhet i gjithë qyteti. Ka edhe shumë për tu bërë do të thonë entuziastët nga "Na toçak", por ata arritën ta kthejnë vëmendjen edhe të pushtetit të kaluar dhe të tashëm lokal për këtë çështje. Propozimet e tyre janë mirë të menduara dhe çdo pushtet ka vizion për të ardhmen dhe i parasheh trendët.

Dhe në fund të përmblidhen këto dy rrëfime, nëse parashtrohen pyetje, cila ka kontribuar për ujë të pastër, kush ngriti iniciativë dhe loboi për shtigje të reja për çiklizëm në kryeqytet? Përgjigja e vetme e mundshme janë qytetarët dhe atë përmes angazhimit të tyre qytetar. Angazhimi nënkupton punë, por me punë me të cilën do të bëhen ndryshime në jetën e komunitetit, si për shembull për banorët e Gjevgjelisë ose në komunitetin e çiklistëve, falë atyre dhe të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion.

Për ndryshim të tillë, nevojitet që puna të përfshijë njohuri dhe shkathtësi, vlera dhe motivim, si ato të aktivistëve të "Arsena" dhe "Na toçak".

Ndërtimi dhe mbrojtja e demokracisë nënkupton vetëm sjellje të ligjeve dhe zbatimin e zgjedhjeve, por i përfshinë dhe të gjitha segmentet tjera në jetën e një shoqërie, që e bëjnë shoqërinë të shëndetshme.

QYTETARËT AKTIV zgjidhin probleme;

QYTETARËT AKTIV zgjidhin liderë më të mirë dhe nxitin lidership më të mirë;

QYTETARËT AKTIV nuk u thonë politikanëve "na thoni çfarë mendoni se çka dëshirojmë të dëgjojmë" por "na thoni të vërtetën dhe ne do t'ju ndihmojmë më mirë ta bëni punën".

Mirëserdhët në numrin e ri të Qytetarët për ndryshime të Civika mobilitas, tema kryesore të cilës është aktivizmi qytetar.

Gonce Jakovleska
Koordinator kombëtar i
Civika mobilitas për IKO

TEMA

ANGAZHIMI QYTETAR

“Të rinjtë në aksion” e ngritën vetëdijen për tregtinë me njerëz përmes 11 fushatave

“Porta e hapur” tashmë 20 vjet vepron në mënyrë aktive dhe siguron ndihmë, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave të tregtisë me njerëz. Më shumë se 1000 të rinj, në nivel vjetor, me inkuadrim të drejtpërdrejtë në aktivitete parandaluese, ndërsa rreth 500 profesionistë janë pjesë e aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve.

Deri tani kanë mbështetur më shumë se 200 viktima të tregtisë, ndërsa rreth 5000 qytetarë në SOS linjën telefonike kanë marrë informata, këshillë dhe mbështetje.

Organizata ka investuar në mbindërtimin e njohurive dhe shkathtësive të rinjve, në fuqizimin e vetëbesimit të tyre dhe shkathtësi praktike, zgjerimi i pikëpamjeve, në krijimin e ideve dhe realizimin e tyre, i motivuan ata ta transferojnë mesazhin më kryesor dhe të kontribuojnë ndaj ndryshimeve në komunitetin e tyre.

Fushata e sivjetme “Të rinjtë në veprim” dhe mbështetja e aktivizmit rinor që e bën “Porta e hapur” ishin shkas për bisedë me Stojne A. Dimishkovska, udhëheqës i programit në këtë organizatë dhe Dimitar Vërglevski nga Prilepi, i cili ishte një nga pjesëmarrësit në fushatat rinore.

QN: Për ata të cilët për herë të parë dëgjojnë, a mund të na sqaroni çfarë janë fushatat rinore dhe cili është qëllimi i tyre? Kush dhe si mund të marrin pjesë?

SD: Një nga aktivitetet që i ndërmarrim për parandalimin dhe edukimin e të rinjve për tregtinë me njerëz janë fushatat rinore. Ato janë aktivitete prej të rinjve për të rinjtë. Përmes kësaj qasje vendosëm model të ri rinor të mësuarit përmes përvojës që është inventive, krijuese dhe para së gjithash i pranueshëm për popullatën e re. Përmes zbatimit të fushatave fuqizohen kapacitetet e të rinjve, por njëkohësisht edhe besimi i tyre se mund dhe dinë të kontribuojnë në jetën shoqërore dhe të bëjnë[ndryshime pozitive mes moshatarëve të tyre. Lëvizja #Mladivoakcija është e hapur për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të inkuadrohen në luftën kundër tregtisë me njerëz. Seleksionimi bëhet përmes konkursit publik, ku të rinjtë në vija të shkurta duhet ta prezantojnë idenë, me të cilën do të kontribuojnë për parandalimin.

QN: Fushatat rinore të cilat i mbështetët në fillim të vitit u zbatuan gjatë pranverës. Na thoni diçka më shumë rreth projekteve.

SD: Në iniciativën #MladiVoAkcija u inkuadruan 11fushata rinore lokale me mision të përbashkët “Bashkë kundër tregtisë me njerëz”. Çdo fushatë mediatike ishte e vetme sipas karakterit të vet, e krijuar nga të rinjtë, por në tërësi e zbatuar nga ata. Mesazhi ishte transmetuar te më shumë se 100.000 qytetarë.

Si produkt final mund të lavdërohemi me filmin dokumentar “Hapi Sytë”, shfaqen teatrore “Në lëkurën tënde”, krijime letrare dhe figurative, ekspozitë multimediale në inkubatorin social, punëtori, kamp skautësh, aksione guerilë, aplikacion për celular etj. Të gjitha produktet multimediale të punuara nga këto fushata mund të shkarkohen në www.lastrada.org.mk dhe fejsbuk grupin – “Bashkë kundër tregtisë me njerëz”.

VAZHDON →

QN: Si reagojnë të rinjtë ndaj tregtisë me njerëz? Pse pikërisht ata janë zëdhënësit Tuaj, por njëkohësisht edhe i gjithë publiku?

SD: Të rinjtë janë nën rrezikun më të madh të këtij fenomeni. Sipas statistikave numri më i madh i viktimave të identifikuara në vend janë të moshës prej 12 deri 16 vjet, ndërsa informimi i tyre rreth kësaj çështjeje për fat të keq është në nivel të ulët.

Të rinjtë gjithmonë kanë qenë udhëheqës të lëvizjeve më me ndikim, duke filluar nga lufta për të drejtat e punëtoreve të tekstilit, e deri te një nga lëvizjet më të mëdha për ndryshimet klimatike që ndodh tani. Të rinjtë posedojnë potencial dhe energji të madhe, të cilat nëse orientohen siç duhet mund të sjellin rezultatet të shkëlqyeshme. Ata janë kreativ, inventiv dhe gjithmonë mund të sjellin qasje të re në punë.

DIMITAR VËRGLEVSKI

QN: Prej ku motivimi të inkuadrohesh në luftën kundër tregtisë me njerëz?

DV: Si shoqëri ndjehemi shumë të sigurt, aspak nuk përpiqemi që të informohemi, e kjo na bënë caqe të lehta. Unë jetoj në Prilep, qytet i bukur, ku qytetarët janë mjaft pasiv dhe nuk janë të vetëdijshëm për kërcënimet nga tregtia me njerëz. Kur e pash thirrjen për aksionet rinore, në njëfarë mënyre ndjeva obligim të bëjë diçka, pasi që për mua është e rëndësishme se në çfarë mjedisi jetoj. Nëse kam mundësi të kontribuoj në ndërtimin e mjedisit të fuqishëm, do ta kisha shfrytëzuar pa dyshuar.

QN: Cila është përvoja jote nga zbatimi i fushatës? Cilat ishin sfidat më të mëdha me të cilat u ballafaqua ekipi yt?

DV: Në procesin e zbatimit të fushatës nuk mund të them se hasëm në pengesa të mëdha. Ajo që më pengonte personalisht dhe që e shihja si sfidë ishte papjekuria e të rinjve. Jo serioziteti të cilin e shprehnin ndaj tregtisë me njerëz, ku në momente aspak nuk e llogarisnin këtë dukuri si kërcënim. Por, jam i vetëdijshëm se ky nuk është faji i tyre, por për shkak të mosfunksionimit të sistemit arsimor dhe kjo është temë e veçantë.

QN: Si e tejkaluat apatinë dhe si i motivuar bashkëqytetarët që të inkuadrohen në fushatë?

DV: Ta tërheqësh vëmendjen e njerëzve pasiv nuk është e lehtë. Mendonim se nëse prekim në emocionet e tyre do ta kishim arritur efektin më të mirë, e kështu vëmendjen e tërheqshim përmes eksperimenteve sociale, të cilat në fillim kishin përmbajtje komike, e njëkohësisht i inkuadronim të rinjtë si personazhe të fushatës. Kur të rinjtë lokal i prezantonim si viktima të tregtisë me njerëz përmes fotografisë dhe video materialeve, publiku filloi ndryshe ta vështroje problemin. Shkalla e ngushëllimit rritej, e me këtë edhe interesimi i njerëzve të dëgjojnë diçka më shumë për tregtinë me njerëz.

QN: Sipas jush, pse është e rëndësishme që të angazhoheni në komunitetin tuaj dhe a mendon se kjo do të sjellë deri te zgjidhja e një problemi konkret?

DV: Asnjë problem nuk është zgjidhur nga individi (të paktën jo në mjediset demokratike). Qëndrimi im personal është se nëse kritikojmë dhe flasim për ndonjë problem, në ndonjë mënyrë edhe jemi të obliguar që të ndërmarrim diçka për këtë. Nuk duhet të ketë frikë nga shoqërimi dhe njerëzit do të duhej të jenë të vetëdijshëm për nevojën nga inkuadrimi i tyre në ngjarjet shoqërore. Kjo nuk do të jetë e lehtë gjithmonë dhe e thjeshtë. Por, ne jemi mjedisi në të cilin jetojmë, ne me veprimet tona e bëjmë shoqërinë ashtu siç është. Në fund të ditës, ne duhet ta marrim përgjegjësinë për situatën në të cilën gjendemi.

Nëse dëshironi më tepër të informoheni për punën e "Porta e hapur", mund të paraqiteni në SOS linjën pa pagesë 0800 11111 çdo ditë pune prej orës 8 deri në ora 20. Porta e hapur është fituese e grantit institucional nga faza e parë e Civika mobilitas.

Aksione guerile të iniciativës "Ndryshe"

Këshilltarët e pavarur të Këshillit të Komunës së Manastirit, Gabriella Ilievska dhe Ivan Çulakoski nga iniciativa e pavarur "Ndryshe", bashkë me ithtarët e tyre u paraqitën në tepihun e kuq në hapjen e festivalit "Vëllezërit Manaki" me triko me mbishkrim "Thuaju reve se Manastiri po vdes".

"Mesazhi jonë është se Manastiri po vdes duke pritur të vijnë kohë më të mira me ndotjen dhe në të gjitha fushat do të bëhen ndryshime. Dëshirojmë të dërgojmë mesazh se qyteti është lënë në harresë. Çdo ditë ballafaqohemi me shpërngulje, sëmundje. Është harruar në gjithë Maqedoninë dhe dëshirojmë t'i përkujtojmë se ekziston. Nuk e kemi për qëllim që ta bojkotojmë festivalin, përkundër ai duhet të ekzistojë,, por dëshirojmë t'i themi opinionit se Manastiri jeton vetëm në atë javë, derisa zgjat "Vëllezërit Manaki", deklaroi Gabriella Ilievska për SAKAMDAKAZAM.MK

"Ndryshe" është shoqatë qytetare e cila gjatë zgjedhjeve të fundit lokale doli e pavarur dhe fitoi dy vende për këshilltar, që ndodh për herë të parë në komunën me mbi 40.000 banorë. Misioni i tyre është t'i zgjidhin problemet lokale dhe drejtpërdrejtë t'i inkuadrojnë qytetarët në vendimet të cilat i marrin të zgjedhurit politik.

Shoqata ka ndërmarr më shumë iniciativa të pavarura, mes të cilave edhe vendosjen e 50 mbajtësve për qeset për mbeturina nëpër rrugët e qytetit, të cilat ishin zhvendosur nga NK "Komunalec", pasi që grumbullimi i mbeturinave jashtë vendeve të shënuara është në kundërshtim me Ligjin për pastërti publike dhe Vendimin për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në sipërfaqet publike në Manastir.

Mes aksioneve tjera për Manastir më të pastër numërohen edhe iniciativa për pastrimin e objekteve ndihmëse të "Shtëpisë së oficerëve", rregullimi i "Çezmës së bardhë" dhe heqja e pllakave dhe rregullimi i stacioneve të autobusit nëpër Manastir.

(Foto: SDK)

"E gjetëm mënyrën e vërtetë t'u afrohemi të rinjve në festivale"

"Pjesëmarrja e sivjetme e HOPS në D-festivalin i tejkaloi të gjitha të mëparshmet", thotë Biljana Maxhar nga HOPS, ndërsa mendimin e saj e ndajnë edhe kolegët tjerë nga organizata, të cilët ishin pjesë e aktiviteteve prej 12-14 korrik në Dojran.

Edhe Biljana edhe kolegia e saj Bllagorodna Koceva-Simjanov potencuan se në dy vitet e kaluara HOPS ka kërkuar mënyra se si t'u afrohen të rinjve dhe të udhëhequr nga misioni që t'i informojnë dhe t'i edukojnë për keqpërdorimin e drogave dhe zvogëlimin e dëmeve nga kjo.

Këtë vit HOPS u ofroi më shumë evenimente edukative me titull "Drogat dhe festivalet muzikore". Evenimentet përfshinë: biseda me psikolog; informata për zvogëlimin e dëmeve nga kombinimi i drogave; punime krijuese me temën (ri)përdore mendjen; ligjërata nga psikiatër me temën: "Kanabisi si potencial për mjekimin e anskiozitetit", bisedë me jurist për të drejtat gjatë takimeve me policinë etj.

"Interesimi i të rinjve të flasin me psikologun na befasoi", thotë Biljana. "Nuk u pengonte të qëndrojnë në tendë dhe të presin bile edhe një orë që të hynë dhe të bisedojnë. Këto janë gjenerata të reja të cilët duket se janë më të hapur për aktivitete të këtij tipi", shtoi ajo. Për dy ditë, mes 30 dhe 40 të rinj kanë qenë në bisedë me psikolog, individualisht ose në grup. Në fillim ata plotësuan një pyetësor, e pastaj patën bisedë me profesionistë të kësaj fushe.

"Kur e vendosëm tabelën ku ishin renditur drogat dhe kombinimi i tyre, të rinjtë shfaqën interesim nga distanca", thotë Bllagorodna. "Në fillim ndonjë fotografi nga distanca, e si kalonte koha filluan të afrohen që më mirë t'i lexojnë informatat, që në fund të lëshohen dhe të bisedojnë rreth

VAZHDON →

kësaj me ne". Ajo thotë se kontaktet e këtilla me të rinjtë, janë mjaft të dobishme sepse në këtë mënyrë edhe ata grumbullojnë informata të cilat u ndihmojnë ta përshtatin qasjen e tyre.

Ekipi kreativ u ndihmoi pjesëmarrësve që të shprehen përmes punimeve të tyre, krijimi i maskave dhe punime tjera për të cilat përdornin shishe prej plastike dhe mbeturina tjera nga festivali.

"Mendojmë se e gjetëm mënyrën e duhur që t'u afrohemi të rinjve në festivale, t'i inkuadrojmë në bisedat edukative dhe informative dhe t'u ndihmojmë që t'i zvogëlojnë dëmet e shkaktuara nga drogat", thotë Biljana.

Pjesëmarrja e HOPS në D-festivalin ishte pjesë e projektit "Aksioni krijues për ndryshime shoqërore: Angazhimi qytetar i njerëzve në rrezik social", që financiarisht u mbështet nga Civika mobilitas.

Aksioni ekologjik – E bardha është e pastër dhe e shëndetshme

Njëzet vullnetarë nga Qendra për zhvillim të qëndrueshëm nga Dibra (QZHQK), 10 të rinj nga qyteti Ifs nga Franca të cilët ishin mysafirë të shoqatës dhe mbi 30 qytetarë të Dibrës, të rinj, pronarë të shitoreve dhe banorët nga pallatet e afërta në rrugën "8 Shtatori" u inkuadruan në aksionin ekologjik të shoqatës për dezinfektim të druve në qendrën e qytetit me gëlqere dhe spërkatjen me insekticid që u organizua më 24 korrik 2019.

"Qëllimi kryesor i aksionit ishte ndërgjegjësimi i opinionit publik te qytetarët e Dibrës për ruajtjen e druve të rinj në aksin kryesor në qytet, si dhe mbrojtja e tyre biologjike dhe atmosferike", tha Shuip Marku, udhëheqës i programit në QZHQK Dibër.

Pjesëmarrësit në aksion i dezinfektuan dhe i lyen me gëlqere mbi 300 trungje. Gëlqerja e bardhë përveç efektit vizual ka edhe efekt për mbrojte nga dielli dhe dezinfektimi i rrënjës së trungut.

Aksioni është pjesë e projektit "Bashkë për Dibrën e pastër" që është mbështetur nga Civika mobilitas - grant akcional.

E lëviz ndryshimin, lexoj "Fytyrë më fytyrë"

Revista e vetme në rrugë në vend, "Fytyrë më fytyrë", e kremtoi ditëlindjen e saj të shtatë gjatë festivalit "Dita e organizatave qytetare" me moton "Lëviz ndryshimin, lexoj "Fytyrë më fytyrë". Shënimi i ditëlindjes ishte mundësi që ta promovojë botimin e 37-të kushtuar ndryshimeve klimatike dhe ambientit jetësor.

"Fytyrë më fytyrë" edhe pas shtatë viteve mbetet e përkushtuar kauzës së vet: zhvillim i qëndrueshëm, fuqizimi i qytetarëve të rrezikuar, të informuar, qytetarë në veprim.

"Me aq shumë energji vallë a ekzistojnë gjasa që mos të kemi sukses ta ndryshojmë narrativin shoqëror që na tërheqë teposhtë? Mendoj se përgjigjën e dimë të gjithë. Qytetari mundet, e këtë përpiqemi ta tregojmë të gjithë ne", tha në fjalën e saj drejtoresha ekzekutive e Publik, Klimentina Ilijevska.

Kjo revistë, si pionier e eci rrugën e sipërmarrësisë sociale në vend që kontribuon drejt re integrimit social dhe të punës të kategorive të rrezikuara përmes kontaktit social, respektimin e rregullave dhe fitimin e shprehive për stilin e strukturuar të jetës, që u mundëson personave të rrezikuar të përgatiten për tregun e hapur të punës.

Shitësit e revistës, ose siç quhen "promovuesit e ndryshimit shoqëror", janë persona të margjinalizuar – të rinj nga rruga mbi moshën 16 vjeçare, të pastrehë, persona me nevoja të veçanta, pranues të ndihmës sociale, shfrytëzues social të drogës dhe alkoolit, ish të burgosur. Nga çdo ekzemplar i shitur (kushton 100 denarë), shitësit e revistës për vete mbajnë 50 për qind nga vlera, e me gjysmën tjetër ndërtohet sistemi për mbështetjen e tyre dhe shtypet numri i ri i revistës.

LGBTI aktivizmi, kyç për dukshmërinë e rritur për problemet e komunitetit të LGBTI

photo: Vancho Dzambaski

Të shtunën e fundit prej qershorit të këtij viti, rrjeti kombëtar për luftë kundër homofobisë dhe transfobisë, në rrugët e Shkupit, e organizuan Paradën e parë të krenarisë "Shkupi prajd", qëllimi i të cilës ishte ta kthejnë vëmendjen e opinionit drejt personave LGBTI, gjegjësisht drejt pabarazisë, stigmës, mospranimit dhe dhunës me të cilën ballafaqohen. Parada filloi nga parku "Gruaja luftëtare", ndërsa pjesëmarrësit lëvizën drejt Parkut të qytetit, ku pas fjalimeve të shkurta mbetën të që të shoqërohen. I gjithë evenimenti kaloi me dinjitet dhe pa incidente. "Shkupi prajd" ishte shkas që të bisedojmë me Irena Cvetkoviq, drejtor ekzekutiv i Koalicionit "Margjinat", anëtare e Rrjetit kombëtar.

QN: Si aktiviste shumëvjeçare për të drejtat e personave LGBTI, a jeni e kënaqur nga ajo se si u zhvilluan Parada e krenarisë në Shkup? Nga numri i mbështetësve që dolën në rrugë? Nga reagimet që i nxiti? Nga reagimet në media?

IC: Kënaqësinë nga Parada e parë e krenarisë në Shkup mendoj se e ndajnë të gjithë ata të cilët e mbështetin luftën për të drejtat e komunitetit të LGBTI. Personalisht mendoj se jam mjaft e kënaqur nga organizimi dhe si u zhvillua ky marsh. Ajo mu më bën veçanërisht të lumtur ishte prezenca pa imponim e policisë, e cila në disa shtete nga regjioni bile edhe e vë në plan të dytë marshin. Më tutje, emocionet dhe energjia të cilën e ndanin të pranishmit, fjalët përshëndetëse dhe mbështetja e kalimtarëve të rastit etj. Më në fund, kënaqësi më të madhe më bëri fakti se në Paradën e parë të krenarisë kishte prezencë të madhe të personave nga komuniteti i LGBTI, të cilët bile seriozisht e tejkaluan numrin e mbështetësve.

Edhe pse numrat nuk janë gjithmonë të rëndësishëm, vlen të përmendet se pritjet dhe dëshirat tona ishte që ta arrijmë numrin prej 500 të pranishmëve. Mund të mendoni sa ishim të befasuar pozitivisht kur në paradë arritën rreth 2000 persona. Mendoj se përkushtimi i madh ka të bëjë me atë se parada e parë ndodhi në kohën e duhur, pa shumë forcë, spontanisht dhe me logjikë. Gjithsesi reagimet janë të ndryshme dhe se ekzistojnë njerëz të cilët mendojnë se asnjëherë nuk është koha për parada, por edhe kjo pritet dhe është normale në shoqëritë demokratike. Ne jemi krenar dhe të lumtur për shkak të mbështetjes së madhe dhe reagimet pozitive të një pjese të madhe të shoqërisë sonë.

Më në fund do të dëshiroja t'i falënderoj edhe mediat, të cilat ishin në lartësinë e detyrës dhe me korrektësi informuan për paradën. Gjuha e urrejtjes ishte prezentë në sasi të madhe, por në mediat sociale, e jo në kuadër të përmbajtjeve mediatike. Ndoshta mu gjuha e urrejtjes u dha motiv një pjese të njerëzve të vijnë dhe të na mbështesin, kështu që arritëm edhe nga më e keqja ta nxjerrim më të mirën.

MARSHI PËR VLERAT TRADICIONALE

Një pjesë e qytetarëve e shprehën mospajtimin e tyre me "Shkupi prajd" përmes pjesëmarrjes në tubimin qytetar-fetar, që u mbajt në ditën e njëjtë me paradën e krenarisë. Motivi i organizatorëve, iniciativa "Aleanca për jetë" ishte të potencohet "vlerat e vërteta tradicionale familjare dhe mënyra e jetës". Marshi filloi ara kishës "Shën Mëria", ndërsa përfundoi para Tempullit "Shën. Klimenti i Ohrit".
Një pjesë e mesazheve të organizatorëve ishin për vendimmarrësit, si të tanishmit, ashtu edhe për ata të ardhshmit. Ata mendojnë se pjesa më e madhe e besimtarëve nuk pajtohen me ri definimin e martesës dhe familjes. "Seksi dhe gjinia janë biologji, e jo ideologji", "Familja tradicionale është gjithmonë në modë" ishin një pjesë e parullave të pjesëmarrësve gjatë marshit.
Marshi u mbështet edhe nga partia Maqedonia Unike.

VAZHDON →

QN: Parada e krenarisë u përputh me 50 vjetorin nga "rebelimi në Stounvol". A jemi kaq prapa me luftën për të drejtat e personave LGBTI?

IC: Paradën e parë të krenarisë në Shkup me vetëdije e paralajmëruam në datën kur shënohej 50 vjetori nga rebelimi në Stounvol. Ekzistojnë dy shkaqe kryesore për këtë: 1. Ta shënojmë këtë ngjarje mjaft të rëndësishme historike për ne dhe 2. Të tregojmë se jemi prapa pikërisht gjysmë shekulli në luftën për të drejtat e njeriut. Ne jemi të vetëdijshëm se jetojmë në shoqërie konservative dhe tradicionale, por po ashtu jemi të vetëdijshëm se edhe populli ynë më shumë e kupton fuqinë e emancipimit të shoqërisë dhe fuqinë e progresit. Me fjalë të tjera, ndoshta jemi parapa 50 vjet, por të paktën hapërojmë përpara në vend se të qëndrojmë në vendnumëro..

QN: Sipas jush, sa ka kontribuar aktivizmi drejt dukshmërisë së problemeve të personave LGBTI?

IC: Aktivizmi, e veçanërisht LGBTI aktivizmi ka rol kyç në dukshmërinë e problemeve të personave LGBTI. Për fat të keq, nga ky aspekt me të vërtetë mbeten prapa akademia, intelektualët, punëtorët kulturor, arsimor, por edhe mediatik. Ajo që më gëzon është se shumë të rinj dëshirojnë të merren me aktivizëm dhe besojnë se mund të jenë bartës të ndryshimeve të cilat i dëshirojnë.

QN: A mund aktivizmi të kontribuojë drejt tejkalimit edhe të problemeve tjera, pa dallim nëse janë të lidhur me grupet e margjinalizuara ose me shoqërinë në tërësi?

IC: Absolutisht besoj në ndërthurjen e ideve dhe vlerave aktiviste, gjegjësisht çdo lëvizje, sa do të bëjë me ndonjë grup konkret ose temë kontribuon për demokratizimin e shoqërisë në tërësi. Vitet e fundit shpesh e dëgjojmë stigmën "Një shoqëri për të gjithë". Pikërisht kjo një shoqëri për të gjithë është e mundur nëse të gjithë bashkë, secili në fushën e tij, lufton dhe investon në kauzën e cila është e mirë dhe e dobishme për të gjithë..

IRENA CVETKOVIKJ

20 vite Kryqi i Kuq në aksion – promovimi i vlerave humane KKA-PHV

Këtë vit, përmes KKA-PHV programi, 1091 të rinj nga i gjithë vendi, ishin pjesë e 150 projekteve të vogla. Zbatuesit ishin të moshës prej 13 deri 17 vjet, e ndonjëherë edhe më të rinj.

Të rinjtë grumbulluan të holla për mjekimin e një fëmije me paralizë cerebrale, ndihmuan gjatë pavarësisë financiare të një personi i cili ka pranuar ndihmë sociale, kanë kontribuar drejt ndjenjës së barazisë mes fëmijëve dhe të rinjve në Qendrën ditore për fëmijë dhe të rinj me kufizime në Veles. Po ashtu, edhe i ndihmuan gjyshes Cava nga Çashka (gruaja më e shkurtër në vend) me atë që i siguruan një bojler dhe e kanë nxitur rinovimin e shtëpisë së saj. I ndihmuan një familjeje me njëmbëdhjetë anëtarë duke u siguruar ushqim, rroba, mjete për higjienë dhe mobile për shtëpinë.

Prej të gjitha projekteve të realizuara në vitin 2019, më me numër, më të suksesshëm dhe më mirë të vlerësuar ishin gjashtë projekte, të cilat i përgatitën 40 vullnetarë të Kryqit të Kuq të Ohrit, me të cilat projekte u ndihmuan më shumë se 100 personave nga kategoria e rrezikuar e qytetarëve.

Shkupi u inkuadrua në Javën globale për ardhmërinë

Shkupi është pjesë e valës globale të zgjimit klimatik! Me energji të mrekullueshme dhe me pjesëmarrje të madhe, me mbështetje të "O2 iniciativës", "Mos u bë plehrë", "Lëvizja për ajër të pastër", "Shkupi smog alarm" dhe "E dua Vodnon"; E premtja për ardhmërinë (Fridays For Future) më 20 shtator e caktuan fillimin e "Java për ardhmërinë" me ngjitjen e kërkesave të tyre para hyrjes së Qeverisë.

"Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme klimatike në nivel kombëtar; aktivizimi i trupit special kombëtar – komisioni për luftë kundër ndryshimeve klimatike; mbyllja e termocentraleve ekzistuese me thëngjill dhe kalimi deri në 80% burime të rinovueshme të energjisë deri në vitin 2030 dhe 100% deri në vitin 2050; plani për zvogëlimin e përdorimit të veturave, bashkë me përtëritjen e plotë dhe zgjerimi i kapaciteteve të transportit publik; vendosja e problematikës klimatike në arsimin formal", ishin vetëm një pjesë e kërkesave të kësaj iniciative.

"I gjithë revolucioni klimatik fillon prej secilit prej nesh, Vazhdimisht themi "Çfarë mund të ndryshoj si njeri?!". Absolutisht mund të ndryshosh – shumë! Një punë mjaft e rëndësishme është aktivizmi. Disi të inkuadrohen më shumë të rinj, për shkak se shumica nga ne, kur jemi në shkollë të mesme, sikur mos të na interesojë çfarë ndodh në botë. Edhe kjo nuk është në rregull. Është fakt se kemi situatë alarmante, e duhet të bëhet diçka për ndryshim të dukshëm. Shembull... nuk duhet të bëhesh vegan, edhe pse kjo është mirë, por është mirë kur shkon në market, të dish se prej nga e ka origjinën ushqimi të cilin e blen", tha Edi Fërcovski, student i biologjisë në FNM.

Ngjarja kishte interesim të dobët mediatik edhe pse pjesëmarrës ishin qindra qytetarë, mes të cilëve edhe shoqata ekologjike me emër.

Më 21 shtator "E premtja për ardhmërinë" mori pjesë në vozitjen me biçikletë nëpër Shkup në organizim të "Eko svest" dhe #NaTocak, derisa një ditë më vonë e mbështeti evenimentin "Pritja e tramvajit të quajtur Dëshira për ajër të pastër" në organizim të "Ne jemi Karposh 4" dhe "EkoKarposh 3 2 1", në suaza të projektit "Eko-remet".

Më 25 shtator, u mbajt panel diskutimi ku morën pjesë tre prej ekspertëve më të mëdhenj për ndryshimet klimatike në shtet: prof. d-r. Risto Ciconkov, autor i raportit të parë për ndryshimet klimatike për Maqedoninë nga viti 2002; prof. d-r Natasha Markovska, përfaqësuese e Maqedonisë së Veriut për Panelin ndërkombëtar për ndryshimet klimatike (IPCC); si dhe m-r Simona Getova, alumni e Universitetit të Evropës Qendrore në Budapest për menaxhment dhe politika për ambient jetësor. M[ë 26 shtator u mbajt punëtoria "Ndërtimi i fuqisë dhe veprimi global" në organizim të Miqtë e rinj të vendit Maqedoni (Young Friends of the Earth Macedonia), ndërsa java përfundoi edhe me një protestë të së premtes, që filloi para Ministrisë së Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Ndërkohë Tatjana Çakulev, aktiviste në organizatën ekologjike "O2 Iniciativa", në intervistën për "Skopsko Eho" theksoi se masat e parapara për këtë vit ose u hoqën nga Programi, i cili pësoi ndryshime në fund të gushtit, ose janë në fazën e thirrjeve publike dhe një furnizim publik, pa marrëveshje të lidhur. Asnjë masë nuk është zbatuar dhe realizuar, edhe pse kjo duhej të ndodhte para fillimit të sezonit të ngrohjes.

Photo: Vancho Dzambaski

LAJME NGA SHOQËRIA CIVILE

Pjesëmarrja qytetare

Struktura udhëheqëse të partizuara në ndërmarrjet shtetërore

Qendra për komunikime qytetare (CGK) e publikoi hulumtimin E drejta ose politika: Zgjedhja e anëtarëve të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse në ndërmarrjet shtetërore.

Gjetjet treguan se Qeveria dhe njësitë e pushtetit lokal nuk kanë dokument zyrtar që e rregullon procesin e seleksionimit të anëtarëve të organeve udhëheqëse të ndërmarrjeve që i themelojnë. Ata, si themelues, nuk publikojnë konkurse për zgjedhje të anëtarëve në organet udhëheqëse në ndërmarrjet shtetërore, nuk kryejnë verifikim të kualifikimit, e as nuk i intervistojnë kandidatët potencial. Procesi i këtillë jo transparent sjell dyshime se listat për emërimin e anëtarëve të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore përpilohen jashtë institucioneve, gjegjësisht në rrethet partiake.

"Në bazë të biografive mund të konstatojmë se në këshillat drejtuese ka pronar të dyqaneve për ar, udhëheqës të pompës për benzinë, shumë njerëz të punësuar në komuna, sekretarë të shkollave, udhëheqës në ndërmarrje tjera shtetërore etj. Lidhur me këshillat mbikëqyrëse të cilët duhet ta kontrollojnë punën financiare të ndërmarrjeve shtetërore, konstatuam se vetëm një e treta me të vërtetë e kanë përvojën e duhur nga fusha e financave, që të mund ta ndjekin punën materiale-financiare të ndërmarrjeve shtetërore", thotë Sabina Fakiq nga CGK.

Nga CGK propozojnë që të miratohet akt nënligjor, ku në mënyrë të qartë do të rregullohet se si bëhet zgjedhja e anëtarëve në këshillat drejtuese dhe mbikëqyrëse. Me të gjitha mekanizmat do të përpiqen të arrijnë deri te kompetentët për realizimin e iniciativës së tyre.



"Llupa e gjelbër" dhe OG Strumicë e ngjallin Ligjin e probacionit

Deri 83% të anketuarve, të burgosur në Institucionin ndëshkimor-korrigjues burgun Strumicë nuk dinë çfarë është probacioni, ndërsa e njëjtë është përqindja edhe e atyre që nuk e dinë çfarë është lëshimi me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur, tregoi hulumtimi i shoqatës "Llupa e gjelbër" dhe "Organizate e grave - Strumicë" të publikuar në fillim të korrikut të këtij viti.

Edhe pse Ligji i probacionit është miratuar në fund të vitit 2016, zbatimi i tij akoma shkon mjaft ngadalë. Opinioni nuk është i informuar aq sa duhet, ndërsa sipas rezultateve nga anketa e këtyre dy organizatave, as ata që janë drejtpërdrejtë të prekur nuk janë të informuar.

ÇFARË ËSHTË PROBACIONI?

Probacioni paraqet "liri me kusht" e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes mbi kryerjen e veprës penale. Qëllimi i Ligjit për probacion është "Mbrojtja e komunitetit nga kriminaliteti dhe risocializimi dhe ri integrimi i personave ndaj të cilëve bëhen punë probacioni" (neni 2). Masat alternative të cilat mund të shqiptohen me këtë ligj janë dënimi me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur, arresti shtëpiak dhe punë e dobishme në komunitet. Krahas risocializimit dhe ri integrimit të personave të dënuar, nga këto masa shteti do të ketë dobi financiare. Sipas m-r Jasmin Kalaç, "një ditë burg në shtetin tonë kap vlerën prej 950 denarë, ndërsa një ditë probacion vetëm 50 denarë" (http://respublica.edu.mk/blog/2019-05-13-08-37-21)

Sipas rezultateve nga hulumtimi, 96% të anketuarve janë të motivuar për risocializim dhe ri integrim në shoqëri, pas skadimit të dënimit dhe nuk dinë se ekzistojnë masa të veçanta të cilat i jep Agjencia për punësim për punësimin e tyre pas skadimit të dënimit.

Dy shoqatat, me aktivitetet nga projekti "Ngjallja e ligjit për probacion në nivel lokal përmes partneriteteve efektive në Komunën e Strumicës", të mbështetur nga Civika mobilitas, organizuan punëtori informative për personat e dënuar, ku i informuan për mundësitë të cilat i ofron Agjencia për punësim, ndërsa të cilat dalin nga Ligji edhe për projektet dhe aktivitetet e tyre të cilat parashohin inkuadrim aktiv të vetë të burgosurve. Nga përgjigjet shihet

VAZHDON →

se 77% janë të përgatitur për t'u aftësuar në ndonjë zeje/ shkathtësi për përpunimin e betonit, bekaton pllakave dhe elementeve tjera nga betoni. Pothuaj të gjithë (93%) janë të sigurt se nuk do të bëjnë ndonjë vepër penale të re, nëse pas skadimit të dënimit kanë vend pune të sigurt, ndërsa paraprakisht janë aftësuar për ndonjë zanat. Kjo është ideja kryesore e projektit të "Zelena lupa" dhe Organizatës së grave – Strumicë me të cilin, krahas informimit dhe ndërgjegjësimit për masat për probacion të gjitha palëve të prekura, 30 persona të dënuar do të përgatiten për tregun e punës, me çka do të kontribuohet që ata t'i plotësojnë kriteret për masën alternative – lirim me kusht.

"Zelena lupa" dhe OG Strumicë në zbatimin e projektit kanë bashkëpunim intensiv me komunën, INK burgu Strumicë, Qendra për punë sociale, nëpunësi i probacionit, Agjencia për punësim, por edhe komuniteti i biznesit.

Mbi 60% të qytetarëve mendojnë se problemet ekologjike duhet t'i zgjidhin komunat

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut organizoi Ditë të hapur për konsultime me sektorin civil për Programet për zvogëlimin e ndotjes së ajrit më 18 shtator 2019. Organizatat qytetare kontribuan përmes iniciativave për zbatimin e masave për luftë kundër ndotjes së ajrit, të cilat kishin të bëjnë me propozimet për identifikimin e ndotësve industrial me shpeshtimin e inspektimeve, si dhe aktivitete dhe masa për efikasitet energjetik dhe masa konkrete për luftë kundër të ashtuquajturve varfëri energjetike.

Ana Çolloviq-Leshoska, nga shoqata "Eko-svest" tregoi për rezultatet nga anketimi i fundit i opinionit publik me fokus të ndotjes së ajrit dhe menaxhimi me mbeturinat, si dy tema të hidhura. Sipas anketës, pothuaj 60% të anketuarve mendojnë se kompetencat kryesore për menaxhimin me ajrin e ndotur qëndrojnë te komunat. Rezultat mjaft i dobët nga anketa thotë se më shumë se 50% të anketuarve nuk dinë se zbatohen masa në këtë fushë ose mendojnë se të njëjtat nuk zbatohen mirë.

Pozitive është se mbi 75% të anketuarve kanë deklaruar se do të bënin ndryshime në jetën e tyre, gjegjësisht do të merrnin kredi me shkallë të ulët të interesit, do të zbatonin masa nëse ndihma financiare është e plotë ose do të zbatonin masa nëse kanë ndihmë financiare të pjesshme.

"Në sektorin civil flasim se në Manastir duhet të ndërmerret diçka më shumë si përgjegjësi. Deri tani me të vërtetë mund ta transferonin në qytet të gjelbër dhe të investohet më shumë në vendosjen e transportit publik", konstatoi Çolloviq-Leshoska, duke e përmendur punën e TEC Manastir si fajtor kryesor pse qytetarët e Manastirit i ndjejnë shumë pasojat nga ndotja e ajrit.

Zëvendës-ministri për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, Jani Makraduli, i prezantoi propozim-masat për kyçje në aktivitetet mes të cilave: vendosja e sistemit informativ shëndetësor-ekologjik për ndjekjen e efekteve nga ndotja e ajrit dhe menaxhimi i sistemit për ndjekje të tipit të materieve ndotëse, dislokimi i deponive të egra në Shkup, dhe përshtatja e autobusëve të vjetër dhe makinave të ndërtimit të cilat ndotin pas vendosjes së sistemeve speciale për riedukim të emetimeve të dëmshme.

Ai po ashtu e paralajmëroi edhe zgjidhjen ligjore për zëvendësimin e stufave me dru te familjet individuale me kondicioner – inverter (burim i rinovueshëm sipas standardeve të BE) të cilat do të subvencionohen 100%.

Vetëm 11% nga prodhimi i përgjithshëm i energjisë është nga burime të rinovueshme

Në fund të vitit të ardhshëm ose në fillim të 2021, qytetarët e Shkupit do të mund të presin se gazi do të arrijë deri te ata, tha Bajram Rexhepi, drejtor i Resurseve energjetike maqedonase (REM) duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve në panel diskutimin "Burime të rinovueshme dhe efikasiteti energjetik për mjedis më të mirë jetësor", që e organizoi Instituti për studime komunikuese (ISK) më 24 shtator të këtij viti.

Sipas kryetarit të Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, vitin e kaluar përfundoi rrjeti sekondar dhe tani do të fillojë faza e fundit pas të cilit gazi do të jetë i kapshëm për amvisëritë. Në panel diskutimin, Shilegov potencoi se një pjesë e kapaciteteve prodhuese dhe industriale janë transferuar në gaz natyror si dhe të gjitha ngrohtoret.

Qytetarët e Gjorçe Petrov, Radishani, Butel, Gazi Babë dhe Draçevë duhet të jenë mes të parëve të cilët do të marrin gaz natyror në shtëpitë e tyre. As atyre, as të tjerëve nuk u shkon në dobi keqkuptimet mes pushtetit qendror dhe lokal, të cilat kanë të bëjnë me konceptet e ndryshme për atë se kush duhet t'i lidhë amvisëritë me gaz natyror. Kjo është veçanërisht nëse prolongimi i zgjidhjes do të thotë prolongim edhe i furnizimit me gaz në amvisëritë.

Krahas gazifikimit që do ta ulte mjaft ndotjen, ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi tha se do të ndërmerren të gjitha masat për efikasitet më të madh energjetik, si ndërtimi i kolektorëve me diell, zëvendësimi i dritareve të drurit me të aluminit, furnizimi i stufave me peleta etj. Ekspertët kërkuan që të shfrytëzohen të gjitha alternativat e burimeve të rinovueshme të energjisë.

Sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë është vetëm 11% nga prodhimi i përgjithshëm i energjisë, thuhet në raportin e dytë dyvjeçar për ndryshime klimatike në Maqedoni. Bile 80% nga nevojat për energji elektrike plotësohen kryesisht me përdorimin e thëngjillit që kontribuon për ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike.

Panel diskutimi është pjesë e fushatës të ISK për mjedis më të mirë jetësor "Mos injoro! Reago!

Vëzhgimi i suksesit të punës së Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit mbajti konferencë për fillimin e projektit "Vëzhgimi i suksesit të punës të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit". Në këtë konferencë u prezantuan metodologjia për vëzhgimin e llogaridhënies të institucioneve të prekura pas vendimeve të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK), me qëllim që të hulumtohet cilësia e veprimit sipas rekomandimeve nga KSHPK, e me këtë edhe të përmirësohet puna e institucioneve individuale.

Marko Troshanovski, kryetar i Institutit për demokraci – Societas civilis, Shkup (IDSCS), theksoi se me këtë projekt dëshirohet të arrihet krijimi i imunitetit kolektiv të institucioneve në luftën kundër korrupsionit, gjegjësisht të pengohet fenomeni, në vend të mjekohet.

"Duke bërë presion publik nga ne si shoqëri civile mbi institucionet për të cilat KSHPK ka dhënë rekomandime për veprim sipas gjetjeve për korrupsion, shpresojmë se institucionet më në fund do të fillojnë ta bëjnë punën e tyre dhe kjo do të kalojë në kapacitetin dhe praktikën e tyre. Do të orientohemi drejt vazhdimit të komunikimit mes KSHPK dhe Platformës, ndërsa tema do të jetë edhe Strategjia kombëtare për luftë kundër korrupsionit ku Parlamenti, duhet të ketë rol më të madh nga aspekti i mbikëqyrjes", tha ai.

Misha Popoviq, hulumtues më i vjetër në IDSCS, e prezantoi metodologjinë për vëzhgim ku është caktuar s enë cilat fusha është më prioritare të intervenohet në luftën kundër korrupsionit. "Kriteri nuk ishte vetëm sa shpesh korrupsioni ndodh në disa fusha, por çfarë ndikimi ka korrupsioni mbi fotografinë në tërësi. Në mënyrë ilustrative, në disa fusha ndoshta ka 1.000 mitë dhënie në vjet, por të gjitha ato bashkë ndoshta paraqesin dëm më të vogël për shoqërinë se sa ndryshimi i korruptuar i një plani urbanistik, me çka kontribuohet mbi ndotjen. Mu qasje të këtillë është e nevojshme ta shohim nga ana e KSHPK", thotë Popoviq.

Të drejtat e njeriut në sektorin e biznesit janë vetëm në letër

Tetëdhjetë përfaqësues nga odat ekonomike, kompanitë, organizatat qytetare dhe ekspertë ndërkombëtar përfunduan se zbatimi i Parimeve udhëheqëse për biznes dhe të drejtat e njeriut të KB (PUKB) në politikat dhe punën e bizneseve në masë të madhe varet nga krijimi i kushteve nxitëse nga ana e shtetit dhe nga përpjekjet e bizneseve dhe organizatat e tyre. Për përkushtimin e shtetit ndaj të drejtave të njeriut dhe lidhshmëria e tyre me EU integrimet folën ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska dhe përfaqësuesi i lartë i Delegacionit i Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Virve Vimpari.

Në fjalën e saj, Nikica Kusinikova, drejtor ekzekutiv i Shoqatës "Konekt", tha se kapitull të ri në mënyrën se si kompanitë anembanë botës e krijojnë biznesin e tyre filloi në vitin 2011 kur Kombet e Bashkuara i miratuan Parimet udhëheqëse për biznes dhe të drejtat e njeriut.

"Derisa paraprakisht shteti e kishte rolin primar në respektimin e të drejtave të njeriut, tani e pranojmë se kompanitë kanë përgjegjësi të barabartë t'i respektojnë në të gjitha segmentet e punës, nga të punësuarit, konsumatorët, zinxhiri i furnizimit, komuniteti ku punojnë. Në vendin tinë korniza për biznes dhe të drejtat e njeriut është shumë pak e njohur, e përmes kësaj iniciative dëshirojmë që kompanitë tona, institucionet dhe aktorët tjerë t'i inkuadrojmë në rrjedhat globale", tha drejtoresha ekzekutive e "Konekt", organizatë e cila vite të gjata punon në nxitjen e përgjegjësisë shoqërore.

Haptazi u diskutua për zbatimin e PUKB në politikat publike të shtetit dhe në politikat e brendshme të kompanive. Krahas kësaj u ndanë gjetjet nga hulumtimi "Respektimi i të drejtave të njeriut në sektorin e biznesit" sipas të cilës kompanitë më shumë në mënyrë deklarative kujdesen për të drejtat e njeriut në vëllimin, ku këtë e kërkojnë rregullat ligjore, derisa një numër i vogël i kompanive, të cilat kanë bërë përpjekje për integrimin e PUKB në politikat e tyre të brendshme dhe zbatojnë verifikim paraprak të drejtave të njeriut. Në praktikë një numër i vogël i kompanive zbatojnë qasje thelbësore drejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vetëm 28% nga kompanitë e kyçura bëjnë vlerësim të rreziqeve lidhur me të drejtat e njeriut, ndërsa 13,6% pastaj ndërmarrin ndonjë qasje të menduar në këtë drejtim.

Për herë të parë pas gjashtë viteve mjedis i përmirësuar mundësues për shoqërinë civile

Në forumin e djeshëm tematik (09.07.2019r.) të Civika mobilitas kushtuar ambientit mundësues për organizatat qytetare, mbi 80 përfaqësues të organizatave qytetare diskutuan për mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile për vitin 2018.

"Mjedisi ku vepronte shoqëria civile gjatë vitit 2018, ishte dukshëm e avancuar për organizatat qytetare. Gjetjet pozitive janë të rëndësishme, veçanërisht duke pasur parasysh se pas gjashtë cikleve të vëzhgimit të mjedisit mundësues, për herë të parë u regjistruan arritjet e shumta në drejtim të mbështetjes dhe zhvillimit të sektorit civil", tha Simona Ognenovska, një nga autoret e raportit për mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile për vitin 2018.

U theksua se liritë e shoqërimit, tubimi dhe të shprehurit ishin të garantuara me ligj dhe kryesisht të respektuara dhe të siguruara në praktikë, ndërsa më e rëndësishme ishte mbyllja e inspektimeve të cilat filluan mbi 22 organizata në fund të vitit 2016.

Korniza financiare për qëndrueshmërinë e shoqërisë civile ishte pjesërisht e avancuar, ndërsa ndryshimet kyçe ndodhën në Ligjin për tatimin mbi fitimin, ku për herë të parë pas përpjekjeve shumëvjeçare të organizatave qytetare, ato u hoqën si subjekte në Ligj.

Në fushën e tretë, raporti mes Qeverisë dhe organizatave qytetare, avancimi i gjendjes është më i theksuar dhe i njëjti reflektohet përmes vendosjes dhe funksionimit efikas të Këshillit për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe miratimi i dokumentit të tretë strategjik Strategjia e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim dhe zhvillim të sektorit civil 2018 – 2020.

Gjatë panelit, Gordana Galiq-Dimitrovska, sekretare shtetërore në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratë foli për inkuadrimin e organizatave qytetare në krijimin e politikave dhe i prezantoi rezultatet nga Raporti i parë vjetor për vlerësim të konsultimeve në vitin 2018.

Përveç kësaj, Biljana Spasovska, nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) i ndau përvojat regjionale lidhur me hapësirat e zvogëluara (shrinking spaces) me të cilat ballafaqohen organizatat qytetare në Ballkan. Mes tjerash, ajo përmendi se udhëhiqet fushatë e zezë kundër shoqatave, aktivistëve dhe gazetarëve hulumtues, derisa shoqëria civile bëhet më e fuqishme dhe vepron si baraspeshe në këtë situatë.

Një pjesë e rekomandimeve të cilat u theksuan kanë të bëjnë me ndryshimet e nevojshme në Kodin penal, me të cilin përfaqësuesit e shoqatave dhe fondacioneve trajtohen si persona zyrtar; vendosja e Ligjit aktual për lobim jashtë fuqisës; si dhe thjeshtëzimi i procedurave gjatë regjistrimit të projekteve të liruar nga TVSH-ja. Lidhur me pritjet për mbështetje të drejtpërdrejtë financiare nga shteti, nevojitet të themelohet fond për zhvillimin e shoqërisë civile, të sigurohet ko-financim për projekte të mbështetura nga donatorët e huaj, pastaj nevojitet që nga praktika e financimit njëvjeçar të kalohet drejt mbështetjes shumëvjeçare organizative dhe të projekteve; të rritet transparenca, efikasiteti dhe llogaridhënia gjatë procedurës së distribumit të mjeteve, por edhe gjatë shpenzimit të njëjtave nga ana e organizatave.

LAJME DHE CIVICA MOBILITAS

Njohje interaktive në zemër të shkupit

Festivali i Civica Mobilitas, i titulluar "Dita e Organizatave të shoqërise civile ", u mbajt në Sheshin Skenderbej dhe në Parkun Ibni Pajko më 14 shtator 2019.

"Sinqerisht shpresoj se ngjarja e sotme do të kontribuojë në forcimin e lidhjeve dhe rritjen e besimit të qytetarëve në Organizatat e shoqërisë civile," tha Shkëlqesia e saj Sibyl Sutter Tehada, ambasadore e Zvicrës në Republikën e Maqedonisë Veriore, në fjalimin e saj përshëndetës në hapjen e evenimentit. Ajo shtoi se prania e qytetarëve "në një numër kaq të madh është një shenjë e qartë se qytetarët po kuptojnë gjithnjë e më shumë se OShC-të janë mënyra më e mirë për ta bërë zërin e tyre më të fuqishëm në luftën e vazhdueshme për të drejtat e tyre." Përveç ambasadores Suter Tejada, fjalime përshëndetëse kishin edhe znj. Ljubica Janceva, kryetare e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Zahir Bekteshi, kryetar i Këshillit të komunës së Cairit dhe Klimentina Ilijevski, Drejtore ekzekutive e Pablik.

Programi përbëhej nga më shumë se 80 ngjarje të cilat zhvilloheshin paralelisht, si dhe shfaqja nga studio e vallëzimit Eat the Beat, revyja e modës nga 15 studentët nga Dibra që sollën modele të prodhuara nga materiale të ricikluara (nga Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm) dhe Dj Goce SAF dhe Strajk.

Vizitorët patën mundësinë të informohen për OShC-të, arritjet e tyre dhe mundësitë për t'u përfshirë në aktivitete. Programi ishte i pasur dhe i larmishëm.

Në këndin kreativ, arsimor dhe rinor u organizuan punëtori, kuize, trajnime, prezentime të video tregimeve mbi temat në të cilat punojnë organizatat. Nga ana tjetër, organizatat e shoqërisë civile në parkun Ibni Pajko organizuan një numër të madh aktivitetesh si kuize, punëtori për mirëmbajtje biçikletash, artizanate dhe punëdore, lojëra për alpinistë të rinjë dhe skautë, ekspozitë të bluzave, monopoli mjedisor, ndihma e parë, mbjellje e drunjëve, testim i HIV-it etj.

Më shumë se 1000 njerëz morrën pjesë në festival. Për një pjesë të tyre kjo ishte mundësi e veçantë për të komunikuar me organizatat e shoqërisë civile, për ti ndarë mendimet dhe idetë e tyre, madje mundësi edhe të përfshihen në ndonjë nismë. Për ata që janë në sektorin e shoqërisë civile, ky ishte një shans i mirë për të rrjetëzuar dhe gjetur partnerë potencial. Organizatat pjesëmarrëse shprehen kënaqësi pasi evenimenti i ndihmoi të rrisin dukshmërinë e tyre, ndërsa disa madje mobilizuan anëtarë të rinj në vendngjarje.



Civika mobilitas i promovoi 27 grantistët e pare

Civika mobilitas, më 9 korrik 2019, në h. Arka në Shkup, i promovoi grantistët e parë të veprimit dhe institucional. Ambasadorja e Zvicrës, ekselenca e saj Sibil Suter Tejada ua dorëzoi grantistëve certifikatat.

Ajo porositi se ata janë bërthama e fazës së re të Civika mobilitas, pasi që janë aktorët kryesor të cilët krijojnë dhe kontribuojnë për ndryshimet në shoqëri.

Gjithsej 12 organizata fituan grante të veprimit të dedikuara për mbështetje të organizatave qytetare të cilat dëshirojnë t'i promovojnë kauzat dhe aktivitetet e tyre me buxhet të përgjithshëm prej pothuaj 21 milionë denarë. Aktivitetet e planifikuara të cilat do t'i zbatojnë janë në sektorët e shëndetit dhe mbrojtjes shëndetësore, demokracisë, informatave dhe komunikimeve, personat me aftësi të kufizuara, mjedisi jetësor, të drejtat e njeriut, sundimi i të drejtës dhe çështjet gjinore.

Në këtë eveniment u promovuan edhe 15 grantistët e ri institucional, buxheti i të cilëve kap vlerën mbi 66 milionë denarë. Këto organizata janë aktive në fushën e informatave, komunikimit dhe mediave; të drejtat e njeriut; zhvillimi i shoqërisë civile; sundimi i të drejtës; anti-korrupsioni; LGBTI; udhëheqja e mirë; mjedisi jetësor; dhe fëmijët, të rinjtë dhe studentët.

Organizatat fituese janë nga regjioni i Shkupit, i Vardarit, Pollogut, Lindor, Verilindor dhe Jugperëndimor.

Ngjitja në "Solunska glava" me rastin e përvjetorit nga shënimi i shtigjeve

Në përvjetorin e parë të shënimit të shtigjeve malore në Jakupicë dhe malin "Solunska glava", e mundësuar me projektin Shërbimi malor Azot të Civika mobilitas, ambasadorja Sibil Suter Tejada, të shtunën, më 20 korrik 2019, e vizitoi Shoqatën bjeshkatare "Çeples" dhe iu bashkëngjit ngjitjes deri në "Solunska glava" (2540 metra).

Gjatë vizitës, ambasadorja kuptoi për sfidat me të cilat ballafaqohen bjeshkatarët lokal, që ta garantojnë sigurinë e alpinistëve, bjeshkatarëve dhe çiklistëve malor në vizitë të Jakupicës. Angazhimi i tyre është vullnetar.

Situata e shtigjeve malore deri në "Sollunska glava" është më e mirë duke iu falënderuar mbështetjes financiare nga Zvicra që përmes Civika mobilitas ishte siguruar dhe për Federatën e sporteve malore të Maqedonisë së Veriut. Federata përgatiti dhe miratoi rregullore dhe procedura për kategorizim, vendosje dhe mirëmbajtjen e shtigjeve, ndikoi te opinioni për nevojën për shtigje të sigurta dhe aftësimin e kuadrove për vendosjen dhe mirëmbajtjen e shtigjeve.

U zgjodhën mentorët lokal për grantistët institucional të Civika Mobilitas

Pjesëmarrësit të cilët hynë në rrethin më të ngushtë të programit "Mentorimi për zhvillim organizativ", filtruar nga Ana Vasilaçe, me sukses i përfunduan aktivitetet lidhur me zhvillimin e shkathtësive dhe të njohurive dhe me këtë u bënë mentorë të gjeneratës së re të grantistëve institucional të Civika mobilitas.

Civika mobilitas do t'i angazhojë Sunçica Sazdovska, Ljupka Simonovsla – Shulc, Ivan Jovanov dhe Maja Smilevska, të cilët do t'i mbështesin grantistët institucional të fazës së re në zhvillimin e Planeve të tyre për zhvillim organizativ. Përveç tyre, Dragana Mitroviq, Marina Gjorgjioska Kitanoska dhe Katerina Vasileska gjithashtu kompletuan programin e mentorimit.

Mentorët janë të gatshëm që t'ua transferojnë njohuritë dhe shkathtësitë organizatave. Gjithashtu, edhe te ata ta ndërtojnë ndjenjën e pronësisë mbi Planet të cilat i përgatisin përmes procesit participativ.

Fokusi në procesin e ardhshëm ka të bëjë me fuqizimin e lidershipit në organizatat e mentoruara, duke kaluar nga lidershipi individual kah lidershipi kolektiv.Ky proces do t'ju ndihmojë grantistëve institucional të bëjnë ndryshimet organizative të nevojshme për të arritur vizionin, misionin dhe qëllimet që organizata përpiqet të arrijë. Në këtë mënyrë grantistët do të inkurajohen të punojnë si një dhe do të kenë ndikim shumë më të madh në shoqëri sesa kur secila prej organizatave do të punonte veçmas.

Programi "Mentorim për zhvillim organizativ" është pjesë e njërit nga instrumentet kryesore për të mësuar në suaza të Civika mobilitas. Qasja e re e mentorimit është një rindërtim i fazës së mëparshme të Civica mobilitas (2014-2018) dhe reagimet e marra nga grantistët e mëhershëm institucional.

www.civicamobilitas.mk

QYTETARËT PËR NDRYSHIME

Kryeredaktor: Gonce Jakovleska

Redaktor: Aleksandra Siljanovska

Adresa e Botuesit: Rr. Nikolla Parapunov nr. 41a, f.p 55, 10160 Shkup

Tel: ++ 389 (0)2 3065 381

e-mail: helpdesk@civicamobilitas.mk

CIVICA MOBILITAS

„Qytetarët për ndryshim" e boton programi Civica Mobilitas i mbështetur financiarisht nga Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), implementuar nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) dhe FCG nga Suedia.

Artikujt e botuar në këtë revistë shprehin pikëpamjet e autorëve dhe/ose organizatave që kontribuojnë në revistë, por jo ato të Ambasadës Zvicerane/Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim ose ato të organizatave implementuese: NIRAS, MCMS ose FCG.

www.civicamobilitas.mk